

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00 и 44/02) и член 30 од Законот за основно образование Службен весник на РСМ, бр. 161 од 5.8.2019 година, министерот за образование и наука донесе наставна програма по Албански јазик за VIII (осмо) одделение на деветгодишното основно образование, избран предмет за учениците од другите заедници.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



PROGRAMI MËSIMOR

**GJUHË SHQIPE (LËNDË ZGJEDHORE)
PËR KLASËN VIII TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR
PËR NXËNËSIT E BASHKËSIVE TË TJERA**

Shkup, 2019

Emri i lëndës	Gjuhë shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera
Statusi i programit mësimor	Lëndë zgjedhore
Klasa	VIII
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	2 orë në javë /72 orë në vit
Qëllimet e programit mësimor	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përforcojë njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara më parë dhe të përvetësojë njohuri dhe shkathtësi të reja të komunikimit; - të zhvillojë aftësitë dhe shkathtësitë e komunikimit: të shprehurit me gojë dhe me shkrim; - të aftësohet për bashkëbisedim, të përdorë fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme dhe nga veprimtaritë dhe dituritë e ndryshme; - të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë tregime, përralla, poezi, biseda dhe përmbajtje të tjera si dhe të jetë në gjendje të bëjë një analizë të thjeshtë të tyre; - të njohë dhe të zbatojë gjatë të folurit dhe të shkruarit rregullat themelore gramatikore e drejtshkrimore të gjuhës shqipe; - të aftësohet të përkthejë fjalë e tekste të shkurtra nga gjuha e vet amtare në gjuhën shqipe dhe anasjelltas; - të përvetësojë në nivelin themelor gjuhën standarde shqipe: të flasë, të shkruajë dhe të lexojë tekste letrare dhe joletrare në gjuhën shqipe.
Fusha programore (njësitë modulare) si pjesë përbërëse të programit mësimor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komunikim dhe lexim (tekstesh joletrare dhe letrare); 2. Gjuhë; 3. Të shprehurit dhe krijimtaria.
Kushtet hapësinore dhe materiale-teknike	Mësimi realizohet në mësonjëtoare ose në kabinet, ndërsa në raste të veçanta shoqërohet edhe me aktivitete përcjellëse që e zëvendësojnë vendin e mbajtjes së mësimin (institucionet e kulturës, institucionet shkencore, biblioteka, kinoteka, medioteka etj.).

Normativi për kuadrin arsimor	Lëndën Gjuhë shqipe në arsimin fillor mund ta realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer: Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.
--------------------------------------	---

Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
1. KOMUNIKIM DHE LEXIM (TEKSTESH JOLETRARE DHE LETRARE)			
- të lexojë, të kuptojë, të shkruajë, të bëjë pyetje e të përgjigjet, të flasë, të interpretojë sipërfaqësisht tekste joletrare që lidhen me jetën e përditshme, natyrën, shoqërinë, komunikimin, arsimin, shkencën, kulturën, sportin etj.;	Tekste joletrare: veprimtaria në klasë, në shkollë, në shtëpi, në rreth; orientimi në hapësirë; rrëfime personale: koha e lirë, dëshirat, shqetësimet dhe ambiciet e tyre; festa, urime, falënderime etj.	- Ushtrime për të pasuruar fondin e fjalëve që kanë mësuar në klasën e mëparshme. - Do të ishte mirë të shfrytëzoheshin materiale audiovizuale nga Interneti e YouTube-ja që lidhen me tema të caktuara mësimore. Metodat: metoda e komunikimit, metoda audiovizuale, metoda e demonstrimit, e krahasimit.	Lexon tekste të ndryshme me intonacionin e duhur; Përgjigjet në pyetjet e parashtruara rreth brendisë së tekstit; Rrëfen dhe shkruan për veten, për dëshirat dhe ambiciet; Krijon rregulla dhe jep këshilla për veprime të gabuara; Orientohet në hapësirë dhe në ambiente të ndryshme; Shkruan tekste të shkurtra mbi bazën e modeleve; Shkruan tekste dhe mesazhe të thjeshta që lidhen me çështjet e jetës së përditshme; Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta si dhe të tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fjali të thjeshta.
- të lexojë, të shpjegojë përmbajtjen dhe të vlerësojë tekste letrare për fëmijë (prozë, poezi, dramë); - të lexojë e recitojë poezi lirike;	Tekste letrare: tregime, poezi, tekste të shkurtra dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëgjëza; Proza, pjesa skenike - dallimet (vargu, dialogu, shkrimi në	- Ushtrime me tekste të zgjedhura nga librat ose burimet tjera të përshtatshme për nxënësit. - Lexohen poezi të shkurtra e të drejtpërdrejta (të pangarkuara	Nxjerr porosinë nga teksti përmes dialogut që zhvillojnë personazhet; Identifikon elemente të teksteve të shkurtra letrare dhe joletrare; Analizon dhe vlerëson tekste të

- të lexojë e kuptojë poezi epike dhe të aftësohet të bëjë dramatizimin e një fragmenti të lehtë të përzgjedhur.	prozë).	me figura letrare). - Ushtrime me tekste të përzgjedhura e të qarta për nxënësit - Të përzgjidhen e të ndiqen nga interneti YouTube-ja përralla e tregime për fëmijë, filma vizatimorë për fëmijë (në gjuhën shqipe), këngë shqipe për fëmijë etj.	shkurtra letrare dhe joletrare; Dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare dhe në tekstet joletrare; Dallon gjuhën e prozës nga ajo e poezisë; Dallon gjuhën e figurshme (letrare) nga gjuha jo e figurshme (joletrare); Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja.
Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
2. GJUHË			
- të dallojë dhe të përdorë drejt emrat në rasa;	Lakimi i emrave	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për të dalluar e përdorur drejt emrat në rasa. Metodat: ndërvepruese (interaktive), e demonstrimit etj.	Dallon dhe përdor drejt emrat në rasa.
- të njohë dhe t'i përdorë drejt parafjalët;	Parafjala	- Ushtrime për të identifikuar dhe përdorur drejt parafjalët.	Dallon disa nga parafjalët më të përdorshme dhe i përdor drejt ato.
- të njohë, t'i shkruajë dhe t'i shqiptojë drejt mbiemrat;	Mbiemri (mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; përshtatja e mbiemrit me emrin)	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të mbiemrave.	Identifikon mbiemrin; Dallon mbiemrat e nyjshëm nga të panyjshmit; Përshtat mbiemrin me emrin në ligjërime.
- të përdorë drejt foljet në mënyra, kohë, vetë e numër;	Folja (zgjedhimi i foljeve)	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të foljeve në mënyra, kohë, vetë e numër.	Identifikon foljet dhe zgjedhon ato në kohët kryesore të mënyrës dëftore. Identifikon kohën e tashme nga koha e shkuar dhe e ardhme. Përdor drejt foljet në mënyra, kohë, vetë e numër.

- të përdorë drejt ndajfoljet;	Ndajfolja	- Ushtrime për dallimin dhe përdorimin e drejtë të ndajfoljeve.	Identifikon ndajfoljet dhe i përdor siç duhet gjatë të folurit dhe të shkruarit.
- të aftësohet të përdorë drejt lidhëzat më të shpeshta;	Lidhëzat	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të lidhëzave më të shpeshta.	Dallon dhe i përdor drejt lidhëzat më të rëndomta.
- të aftësohet të përdorë drejt pasthirmat më të rëndomta;	Pasthirrma	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të disa pasthirmave.	Dallon dhe i përdor drejt pasthirmat më të rëndomta.
- të aftësohet të shqiptojë me theksin e duhur fjalët e fjalitë;	Theksi në gjuhën shqipe	- Komunikim me gojë e lexim tekstesh (joletrare e letrare) për të përmirësuar theksimin e saktë të fjalëve e të fjalive.	Shqipton me theksin e duhur fjalët e fjalitë.
- të njohet me konceptin se çfarë është fjalori dhe të njihet me llojet e tyre; - të mësohet si gjendet fjala në fjalorë dhe të këshillohet që të përdorë fjalorë;	Fjalorët dhe llojet e tyre	- Do të demonstron në klasë përdorimi i Fjalorit drejtshkrimor të shqipes si dhe në kompjuter përdorimi i Fjalorit drejtshkrimor elektronik dhe Fjalorit shpjegues elektronik (AS2O).	Di dhe fiton shkathtësinë e përdorimit të Fjalorit drejtshkrimor të shqipes si dhe Fjalorin drejtshkrimor elektronik dhe Fjalorin elektronik shpjegues të shqipes.
- të fitojë njohuri për veçoritë kryesore të stileve funksionale në gjuhën shqipe (stilin shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror, stilin e letërsisë artistike dhe stilin fetar);	Stilet funksionale	- Do të lexohen e analizohen tekste nga stili shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror dhe stili i letërsisë artistike.	Lexon, kupton dhe di të thotë disa veçori të stilit shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror dhe të stilit të letërsisë artistike.

Sqarim:

Përmbajtjet mësimore të fushës programore *Gjuhë* realizohen nëpërmjet përmbajtjeve të njëjësive modulare të tërësive tematike komunikim dhe lexim si dhe të shprehurit dhe krijimtaria, që do të thotë se ato janë integruar në njësitë komunikative për të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Përmbajtjet mësimore të *Gjuhës* në program janë shënuar si tema më vete, por realizimi i tyre nuk nënkupton interpretim metagjuhësor, d.m.th. shpjegim ose përkufizim gjuhësor. Aftësitë gjuhësore të përfshira në këto përmbajtje mësimore

nxënësit i përvetësojnë në mënyrë pragmatike – nëpërmjet të dëgjuarit, të vërejturit, shqiptimit, kopjimit, përsëritjes, të treguarit, të biseduarit etj.			
Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
3. TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA			
- të zhvillojë bashkëbisedime që lidhet me komunikimin në jetën e përditshme;	Bashkëbisedim (dialog)	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për të zhvilluar një bashkëbisedim të shkurtër. Metodat: metoda e komunikimit, metoda ndërvepruese (interaktive), metoda audiovizuale, e demonstrimit, e përkthimit etj.	Di të zhvillojë bashkëbisedime që lidhen me komunikimin në praktikën e përditshme.
- të tregojë gjëra që lidhen me përjetimet vetjake, të tregojë një ndodhi, përmbajtjen e një libri të lexuar, një filmi të parë etj.;	Tregim	- Nxënësit punojnë në grupe; formulojnë idetë e tyre dhe i shënojnë në fletore...; zgjedhin formulimet më të mira për t'i prezentuar në nivel të grupeve...	Di të tregojë gjëra që lidhen me përjetimet vetjake, të tregojë një ndodhi, përmbajtjen e një libri të lexuar, një filmi të parë etj.
- të ritregojë me pak fjalë përmbajtjet e dëgjuara (të lexuara nga arsimtari, prindi, radioja apo televizori...);	Ritregim	- Ushtrime të të shprehurit lidhur me ritregimin e ndonjë ngjarjeje të përjetuar a të dëgjuar, të ndodhur në shkollë a gjetiu.	Do të ritregojë me pak fjalë përmbajtjet e dëgjuara (të lexuara nga arsimtari, prindi, radioja, televizori, interneti etj.).
- të aftësohet të përshkruajë frymorë, sende dhe dukuri nga temat e parapara...;	Përshkrim	- Ushtrime për përshkrimin e sendeve, dukurive dhe frymorëve... - Ushtrime për të përshkruar frymorë e sende, mënyra të kryerjes së veprimeve; vetitë e frymorëve dhe sendeve etj.	Është në gjendje të përshkruajë frymorë, sende dhe dukuri që lidhen me temat e parapara...
- të aftësohet formën e folur të ligjëritimit ta shndërrojë në formë	Diktim	- Diktimitë tekstesh të shkurtra për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit	Me korrektësi e shkruan atë që e dëgjon.

të shkruar;		(identifikimi i përbërjes tingullore të fjalëve dhe shënimit të tyre me shkronja, përdorimi i shenjave të pikësimit etj.).	
- të aftësohet të përkthejë fjalë, shprehje e fjali të shkurtra nga shqipja në gjuhën e vet amtare dhe anasjelltas.	Përkthim	- Ushtrime përkthimi fjalësh, shprehjesh e fjalish e tekste të shkurtra.	Di të përkthejë nga shqipja në gjuhën e vet amtare e anasjelltas fjalë, fjali e tekste të shkurtra.

Vlerësimi i arritjes së nxënësve	<p>Vlerësimi i rezultateve është i detyrueshëm dhe bëhet sipas normave ligjore. Përparimi dhe vlerësimi i nxënësve ndiqet rregullisht dhe kryhet në vazhdimësi gjatë orëve mësimore, me qëllim që vlerësimi t'u shërbejë nxënësve për të ditur gjendjen reale të diturive të veta si dhe do të stimulohen për përmirësimin dhe thellimin e përhershëm të tyre. Në përputhje me natyrën e programit të lëndës së Gjuhës shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera, vlerësimi mund të bëhet nëpërmjet formës me gojë dhe me shkrim ose me ndonjë formë tjetër.</p> <p>Instrumenti gojor i vlerësimit përfshin përgjigjet që jep nxënësi në pyetjet e bëra, parashtrimin e pyetjeve (për nxënës) dhe zhvillimin e bashkëbisedimeve të shkurtra.</p> <p>Instrumenti shkrimor parapëlqen ushtrime për nxënien dhe përvetësimin e alfabetit të shqipes (shkronjave të shtypit dhe të dorës).</p> <p>Vlerësimi bëhet në një temë të caktuar, gjatë tremujorshit, gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor.</p> <p>Për nxënësit që nuk i përvetësojnë në nivelin e mjaftueshëm njohuritë, detyrimisht organizohet mësim plotësues.</p> <p>Nxënësi vlerësohet me notë numerike.</p>
Literatura dhe burime të tjera	Libri shkollor i miratuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës (libër me vizatime, doracak mësimdhënës për zbatimin e aktiviteteve programore, material për lexim dhe shkrim fillestar të shkronjave të shtypit dhe të dorës), tabelë interaktive, Internet (softuera arsimorë, ueb-faqe), aplikacione mobile etj.
Institucioni/ bartësi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit (BZhA)

Потпис и датум на донесување на наставната програма	бр. 12-11216/4 28.10.2019 година МИНИСТЕР, ср. Dr. Arbër Ademi
Датум на ревизија	